



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

-Sektori i Kuvendit-

01Nr. 060/01-25943/21
Kaçanik, 31.08.2021

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **IX-të (Nëntë)** e Rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2021 (Legjislatura e VI-të), mbajtur me 31.08.2021. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, më fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës prej 27 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje fillimisht ishin 27 anëtarë, të gjithë.

Prej strukturave ekzekutive të komunës, në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, drejtorët e drejtorive komunale; Bahri Selimi, Ramadush Osmani, Festim Neziraj dhe Fatmir Loku, ndërkaq nga zyrtarët e komunës ishte Fatlume Guri-Selimi.

Nga strukturat vendore, mbledhja monitorohet përmes, Teleprezencës nga Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e lartë për monitorim të Komunave në MAPL.

Mbledhjen e kryesoi, Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit,
Procesmbajtëse, Arbnora Kuka, Asistente e Kryesuesit të Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli, Të nderuar pjesëmarrës të kësaj mbledhje, së pari iu përshëndes të gjithëve, iu dëshiroj mirëseardhje, konstatoj pjesëmarrjen duke i thirrur emër për emër, kushte pune me u mbajtur mbledhja ka, andaj e hapi mbledhjen e IX-të (Nëntë) të Rregullt për vitin 2021, data 31 Gusht, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Raporti financiar për periudhën Janar- Qershor 2021;
3. Propozim Vendim për transfer të mjeteve sipas buxhetit të vitit 2021; dhe
4. Propozim Vendim për aprovimin e listës së veçantë të pronave komunale të cilat do të jepen në shfrytëzim në vitin 2022.

Lidhur me rendin e punës e hapi diskutimin:

z.Selim Reka,Përshëndetje për të gjithë. Propozoj që në rend pune, si pikë e re të futet moskthimi i laptopëve që i kemi marrë, në fillim të mandatit, ku edhe kemi nënshkruar një kontratë që të kthehen.

Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli, Nuk e di si duhet të veprojmë. Ne kemi mundur që në fillim ta ngritim këtë çështje. Nëse është aset i komunës , duhet të kthehet.

z.Ekrem Kyçyku, Faleminderit kryesues, ju përshëndes të gjithëve. Të na mbetet si kujtim prej Kuvendit, sepse disa nga ne nuk do të kandidojnë. Kemi edhe diskutimet dhe të gjitha materialet e Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli, Ndoshta mund t'i bëjmë pa vendim të Kuvendit, por me vendim të Kryetarit. Pasi që Kryetari dhe drejtori janë këtu, i kanë këto kompetenca. Atëherë rendin e punës e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës e,

Aprovoj

Rendin e punës në përbërje prej 4 pikave.

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas radhës:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;

Procesverbali i mbledhjes së kaluar të Kuvendit të Komunës u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës e,

Aprovoj

Procesverbalin e mbledhjes së VIII-të (Tetë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës të datës 30.07.2021 / Lënda: 01Nr. 060/01-21074/21.

Kryesuesi i Kuvendit, Para se me kaluar në pikët e dytë, procedojmë me;

Pyetje dhe Kërkesa

z.Ekrem Kyçyku, Mbledhjen e kaluar kam ngritur një shqetësim për problematikën e ujit në komunën tonë, sidomos pjesën lart. Kam bërë apel që qeveria komunale të merr të gjitha masat për parandalimin e keqpërdoruesve të ujit. Brenda ditës kam bërë 5 fotografi të keqpërdoruesve të ujit në lagjen time. Nuk është ndërmarrë asnjë hap lidhur me këtë çështje.

2. Kam edhe një fotografi të shetitores, dy blina janë tharë, për shkak të moskujdesit të komunës që nuk kanë qenë në gjendje të organizojnë një cisternë për ujitjen e blinave.

3. Lagjia ime është lënë anash nga komuna. Dimrit nuk pastrohen rrugët nga bora. Tash ka kanalizime në rrugë dhe në hyrje te plepi është e pashtuar, është një grop dhe nuk është ndërmarrë asgjë. Policia rrugore anëherë nuk hy në këtë lagje. Mos të flasim për investime që kam bërë kërkesë 4 vite, asnjëherë nuk është aprovu.

z.Bekim Koxha, Faleminderit kryesues, ju përshëndes të gjithëve. Kam një shqetësim që jo vetëm tash, por ka 4 vite, prerja e pyjeve është duke u heshtur dhe nuk e di deri kur do të heshtet. Këtu ka pasur edhe anëtarë të LVV që shumë kanë bërë zhurmë lidhur me prerjen e pyjeve, mirëpo edhe këto kanë hasur në vesh të shurdhër. Edhe pse e kanë qeverisjen lart, prap mali i sharrit është duke u prer, dhe nuk është ndërmarrë asgjë. Deshta t'i bëjë pyetje anëtarëve të LVV, nëse kanë bërë ndonjë komunikim me Ministrinë e Bujqësisë apo kush e menagjon dhe nëse kanë ndërmarrë ndonjë hap. Faleminderit.

z.Ekrem Kyçyku, Është e vërtetë se kemi qenë të zëshëm, dhe nuk jemi ndalur asnjëherë. Kam qenë pjesë edhe e një task force këtu. Dje kam komunikuar me telefon me Liburn Aliu, kam pasur edhe një takim një muaj më parë në Ministri me Liburn Aliun. Më e reja është se dje kam pas një telefonatë nga Liburn Aliu. Na ka ftuar në një takim bashk me Xhelal Sfeqlën, pastaj edhe me një grup tjetër, për të marrë masa. Ju e dini që edhe këtu kemi mbajtur mbledhje që kanë marrë pjesë prokurori, gjykatësi dhe komandanti i policisë, por nuk kemi pasur sukses.

z.Bekim Koxha, Nuk kisha kritikë, por pasi që edhe këto janë ankuar dhe deshta të marrë përgjigje prej tyre, pasi që Qeveria është e LVV.

Znj.Nazife Krasniqi, Faleminderit kryesues, ju përshëndes të gjithëve. Kam një kërkesë lidhur me situatën me Pandeminë Covid-19. Dihet që vaksinimi po bëhet , por nuk e dimë ku është çëshja , ndoshta në Ministri. Dy të Shtune nuk është punuar me vaksinim, kemi pasur termine dhe nuk kanë punuar. Shihet se është problemi te mungesa e vaksinave.Duhet të fokusohemi aty. Nëse ka mundësi edhe diçka tjetër me lënë anash dhe me punu aty, duhet të punohet edhe në vikend.

Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli, Pasi është situata me Pandeminë Covid-19, ndoshta edhe kjo pyetje nuk ka kohë të pres përgjigje me shkrim deri në mbledhjen e radhës, unë ja jap fjalën Kryetarit që të na njofton me gjendjen në QKMF, me mirëkuptimin tuaj.

Kryetari i Komunës,z.Besim Ilazi, Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë. Jemi dëshmitarë të asaj që përmes mediave ka qenë edhe prononcim i Ministrit, që për shkak të mungesës së vaksinave, është ndërprerë vaksinimi të shtuneve dhe të dielave dhe plani që ka qenë për rritjen e kapaciteteve, ekiyeve tjera, deri në një vendim të ri. Është vendim i nivelit qendror, për këtë arsye nuk ka edhe termine, për shkak të mungesës së vaksinave. Momenti kur të vjen kontigjenti i ri i vaksinave, sipas Ministrit që pritet me ardh shumë shpejt, shpresojmë të rritet edhe kapaciteti i ekiyeve dhe do të punohet të shtuneve dhe të dielave.

z.Bekim Koxha, A ka mundësi të bëhen edhe pika tjera të vaksinimit si : Doganaj, Dubravë, Kaçanik i Vjetër etj.?

Kryetari i Komunës,z.Besim Ilazi, Është ngritur ky shqetësim në nivel vendi, por problemi është se duhet të ketë friza dhe ekiye që duhet të ketë edhe mjek, për shkak të mungesës së kapaciteteve , besoj që nuk kemi mund të arrijmë, ndoshta duke parë situatën. Momentalisht është mungesë e vaksinave, që pritet javën tjetër të vij kontigjenti i ri i vaksinave, dhe besoj që do të jetë një lehtësi sepse kemi kërkesa edhe të qytetarëve , sidomos ato që udhëtojnë në Tetovë dhe studentat që banojnë aty, pa vërtetim të vaksinimit , nuk i lejojnë të banojnë në konvikte. Po presim një vendim të ri të Qeverisë.

Znj.Lirije Luta, Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë.Kam një pyetje për DAK, deshta të di a janë të vaksinuar të gjithë mësimmshënësit, pasi që tash fillon viti shkollor. Poashtu kam një kërkesë për shpërndarjen e librave për klasat e para, sepse gjatë vitit të kaluar nuk ka pasur menagjim të mirë. Mendoj që klasave të para duhet t'i kushtohet një rëndësi e veçant, pasi që vetëm sa kanë filluar mësimin.

2.Raporti financiar për periudhën Janar-Qershor 2021

Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli, Materialin e keni marrë, drejtori i DEFZH është këtu dhe nëse keni ndonjë pyetje urdhëroni.

z.Selim Reka, Organizata buxhetore e komunës ka operuar me 13 programe buxhetore. Nga pasqyrat nga tabela 1. Granti i përgjithshëm i shpenzimeve janë më të ulëta krahasuar me një vit më parë, për 30,000.00€. Te tabela 2. Raporti i inkasimit të të hyrave vetanake , qëndrojnë mirë në tatimin pronë, tokë , gjoba nga inspektoriati edhe pse akoma nuk jemi të kënaqur te gjobat nga inspektorati.Te regjistrimit të trashëgimisë, taksave administrative, legalizimit të

objekteve, shfrytëzimi i pronës publike, taksa për ndërrim destinimi të tokës. Do të thotë të gjitha këto kanë pasur ngritje. Ndërsa ato që kanë pasur regres janë taksa komunale për leje ndërtimi, taksa për matjen e tokës në teren, taksa tjera ofiçare administrative si dhe inspektimi higjieniko-sanitar. Te tabela 3. Duket se është një gabim teknik.p.sh. te bujqësia janë paraqitur të hyrat që kanë të bëjnë me Çertifikata. Te shpenzimet e realizuara, për kundër që ka progres krahasuar me një vit më parë, prap është brengosëse realizimi vetëm 36.26%, nga ajo që është planifikuar, në veçanti te shpenzimet kapitale me vetëm 15.19% ndaj asaj që planifikohen. Kjo është një shqetësim i madh, tani kur jemi në muajin 8 dhe me gati 75% e mjeteve të pashpenzuara. Te tabela 4, kisha një pyetje për drejtorin e Drejtorisë për Shërbimeve Publike. Çka përfshihet në shumën 140,000.00€, për mallra dhe shërbime? Te tabela e dytë e shpenzimeve komunale është mirë që ka një ulje të shpenzimeve për afër 28%. Dhe rritje të subvencioneve. Te tabela e planifikimit dhe realizimit të projekteve kapitale për periudhën janar –qershor 2021, gati të gjitha projektet mbeten në fazën fillestare. Nuk ka filluar gati anjë nga projektet e parapara si: sheshi i qytetit, as rehabilitimi i rrugës “Qamil Ilazi”, rruga “Sali Bajra”, Rruga Kotlinë – Ivajë, rregullimi i parqeve publike, zhvillimi i turizmit dhe rregullimi i shkollave, sidomos oborrit dhe shkallëve te Gjimnazi “Skenderbeu”.

z.Besim Vishi, Faleminderit kryesues, ju përshëndes të gjithëve. Te tabela e shpenzimev....disa sqarime më konkrete. Ajo që kam selektuar është faqe 5, tabela 3, shpenzimet komunale janë zvogëluar për 27.96%. Faqe 7 tabela e përmbledhjes së shpenzimeve, numri 13360- shpenzimet e telefonisë mobile- administrate e përgjithshme, Në bazë të tabelës 4, administrate i ka 29 punëtor, ndërsa shpenzimet e telefonisë mobile për administrat janë diku 2023.00€. 29 punëtor nëse i pjestojmë, përafërsisht i bie 70euro për punëtor. Nëse e marrim gjashtëmujor, përafërsisht i bjen ka 10€ në muaj i hargjon një punëtor. Te numri 13490- shpenzimet e varrimit nuk ka shënim sepse te faqe 8, I ke shpenzimet e kategorisë për subvencione dhe transfere, janë të rritura sepse një prej tyre është pagesa ndaj Bashkësis Islame për raste mortore. 13620- shpenzimet e furnizimit me ushqim dhe pije TM2 2021 janë diku 9,401.67€ ndërsa në TM2 2020 janë 68,559.52€. Pse është kjo diferencë aq e madhe? Faqe 9 – Planifikimi dhe realizimi i projekteve kapitale. Te shpenzimet më intereson të di, te Buxheti dhe Financa, bashkëfinancimi i projekteve, konkretisht cilin projekt është bashkëfinancim vlera 70,000.00€. Te shërbimet publike, shënohet edhe rregullimi i ndriçimit publik, ku është bërë ndriçimi public. E them me shkas se ka tri vite që kam bërë kërkesë për lagjen Vishi, por nuk është bërë asgjë. Nuk kam asgjë kundër, por janë bërë me ndriqim publik lagjja Imisht dhe lagjja Malsiu, por pse është ndarë lagjja Vishaj. Ndërsa lagjet Topall, Dallosh e kanë bërë ndriçimin publik me vetfinancim ashtu sikur lagjja Vishaj. Te planifikimi, te urbanizmi-renovim i objekteve banesore kolektive në vlerë 20,000.00€, më konkretisht cila banesë është renovuar?

Znj.Arlinda Rakoci- Raka, Faleminderit kryesues, ju përshëndes të gjithëve. E tha edhe parafolësi, unë deshta një sqarim te 13620, shumë e madhe për furnizim me ushqim e pije vlera 4,311.44€ për 6 muaj, te DAK, pastaj te shërbimet publike dhe DUKMM. Deshta një sqarim më në detaje.

Z.Adnan Reka, Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë. Edhe unë mendoj që ky raport tregon një performance të dobët të realizimit të buxhetit deri muajin Qershor. Te inkasimi e kemi një përqindje mjaft të lartë, por unë mendoj që ajo është e stimuluar, sepse, po të ndalemi te taksa për shfrytëzimin e resurseve natyrore, I kemi mbi 300% të realizuar, se kjo e rrit përqindjen e përgjithshme, por jo edhe performancën buxhetore. Ndërsa po të ndalemi te shpenzimet kemi shpenzuar vetëm 36.26% të buxhetit, dhe atë 15.63% shpenzime komunale dhe vetëm 15.19% - shpenzime kapitale. Ndërsa po të shkojmë te faqe 9, planifikimi dhe

realizimi I projekteve, prap shohi shumë projekte që janë të planifikuara, por asnjëher nuk janë realizuar. Prandaj unë konsideroj që është një performancë e dobët buxhetore.

Z.Bahri Selimi, faleminderit kryesues , përshëndetje për të gjithë. Në përgjithësi Raporti gjashtëmujor mendoj që është pozitiv. 36.26% shpenzimi, afër 50% janë të hyrat vetanake të realizuara, 1.54% e kemi indeksin e ngritjes së shpenzimeve, në krahasim me vitin e kaluar. E kemi përmend edhe në KPF, disas hqetësime që u ngritën te realizimi i projekteve kapitale, e kemi ende jofunksional bordin e organit shqyrues të prokurimit publik. Jp vetëm ne si komunë por të gjitha komunat. Faji është i Qeverisë. Tabela 4. Te Drejtoria e Shërbimeve Publike-mallra dhe shërbime në vlerë 140.421.06€. Pas kësaj table e keni analitikën e mallrave dhe shërbime, ku jepen sqarime ku kanë shkuar mjetet. Konkretisht , nga 140,421.06€ ; Mirëmbajtja e rrugëve lokale- 132,052.73€, dreka zyrtare- 344.50€, mirëmbajtje dhe riparim të automjeteve – 623.00€, sigurimi i automjeteve 75.00€, paraja e imët (paty cash)- 500.00€, derivate për vetura- 1,040.65€, është drejtori e cila i mbikqyr shumicën e projekteve kapitale dhe i ka menagjerët në teren. Shpenzimet për furnizim me ushqim dhe pije- 2,310.38€, shpenzimet e furnizimit për zyrë- 994.00€, shpenzimet e shërbimeve kontraktuese- 2,480.80€, ku kjo drejtori , deri në vitin e kaluar ka mundur me kontrata në vepër apo me kohë të caktuar të angazhojë staf për mirëmbajtje të hapësirave të ndryshme. Këtë vit ka lidhur kontratë me “Pastërtinë”, që është kontratë e ligjshme dhe 2,480.00€ ka kushtuar mirëmbajtja e hapësirave , varrezave etj. I kemi të gjitha analitikat e tabelave . Çdo shpenzim i kësaj periudhe gjashtëmujore është raportuar në mënyrën më transparente. Shpenzimet komunale kemi rënje për 27.96%. Shpenzimet e telefonisë mobile , 13360 i përkasin kategorisë së mallrave dhe shërbime. i kemi dy shpenzime të telefonisë. Te komunalitë është telefonia fikse. Te 13360 i përkasin telefonisë mobile. Shpenzimet e varrimit nuk ka vlerë. Vitin e kaluar kanë qenë afër 15,000.00€, por me rekomandim të auditorit të jashtëm, nuk i paguajm nga mallra dhe shërbime , por i paguajm me subvencione. Subvencionet kanë pasur ngritje edhe për arsye të disa vendimeve të Kuvendit të Komunës, për pagesa. Te DAK ju është dhënë prioritet më i shpejt për pagesën e të gjitha klubeve sportive dhe OJQ, Shoqërive Kulturore Artistike. Furnizimi me ushqim e pije, viti I kaluar ka qen vit kur kemi hy në Pandemisë Covid-19 dhe së bashku me ju kemi marrë vendim për ndarjen e 100,000.00€, për menagjimin e Pandemisë, furnizimi me pako të ndryshme ushqimore dhe higjienike. Dhe të gjitha janë në këtë kod 13620. 4,311.00 janë për qerdhe, furnizim për fëmijët. 1,573.00€ te DUKMM. Në përgjithësi për investime kapitale , përgjigjet i mbeten drejtorit të DESHP. Investimet kapitale i kemi për 15.19% apo rritje për 50% krahasuar me vitin e kaluar. Te të hyrat më shumë kemi realizim te tatami në prone. Te shumica ka edhe rënje. Te shfrytëzimi I pronës punlike ka rënje, por e kemi respektu vendimin e Kuvendit Komunal për lirim nga qiraja. Poashtu te shëndetësia kemi rënje për 3652.00, mirëpo me Vendim të Kuvendit i kemi liruar qytetarët nga participimet. Bashkëfinancimi është te DEFZH, e kemi marrëveshje për bashkëfinancim Bulevardin “Ismail Raka”, pagesat e deritashme janë 70,088.40€.

Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli, Faleminderit drejtor. Besoj që sqarimet ishin të duhura. Për pakon e telefonisë mobile dihet se janë të përfshirë të gjithë numrat në rreth siç janë edhe anëtarët e Kuvendit të Komunës, Punëtorët e Arsimit Shëndetësisë etj. dhe është kontratë vjetore.

z.Ramadush Osmani, sqarim rreth shumës 140,421.06€. Aktive i kam 4 kontrata: mirëmbajtja verore dhe dimërore është kontratë 2 vjeçare , me vlerë 450,00.00€, me plus minus 30% që lejohet me ligj. Mirëmbajtjen e sinjalizimit horizontal dhe vertikal me kontratë 3 vjeçare , në vlerë 75,000.00€, mirëmbajtja e hapësirave gjelbëruese dhe mirëmbajtja e ndriçimit publik . Të gjitha janë kontrata me mallra dhe shërbime dhe kanë të bëjnë me mirëmbajtje. Ndërlidhem me pyetjen e z.Ekremi, i kemi 342 drunj, ndërsa dy drunj qenkan tharë. Për këtë arsye e kemi edhe

mirëmbajtjen e hapësirave gjelbëruese, ku hyn pozicioni i ujitjes, i prashitjes dhe i krasitjes së drunjëve. Tek planifikimi i ndriçimit publik edhe sivjet kemi ekzekutim. I kemi 110,000.00€, të planifikuara, ku prioritet i drejtorisë do të jenë pjesa urbane të finalizohet dhe rrugët kryesore të fshatrave. Pasi të kryhen rrugët kryesore të fshatrave mund të hyjmë në degëzime nëse ka nevojë. Investimi në lagjen Vishaj, nëse një komunitet është i gatshëm të bashkëfinancoj në projekt, mirëmbajtjen dhe pagesën e rrymës e bënë drejtoria. Kështu ka shkuar në lagjen Vishaj.

z.Besim Vishi, Rrugën kryesore e lagjja Imisht dihet ka është, tani ka qenë një anashkalim i rrugës vishaj. Te lagjja imisht është bërë komplet ndriçimi, ndërsa në Vishaj e kanë realizuar vet.

z.Ramadush Osmani, Rruga "Beteja e 25 majit" e ka një segment të qarkullimit, e ka hyrjen te Varrezat e Dëshmorëve dhe daljen në "sepetin". Në vlerësimet e drejtorisë dhe në arsyeshmërinë e projektit, ne nuk mund të vendosim ndriçim publik në pjesën ku nuk ka banim. Këtë vit po bëhet rruga kryesore në f.Begracë deri te kryqëzimi me rrugën e Vitisë. Nëse fillojmë me lagje atëherë krijohen shumë kërkesa të lagjeve tjera.

z.Besim Vishi, Pse të dallohen lagjet Malëzezë dhe Qorraj.

z.Ramadush Osmani, Lagjja Vishaj është lagje e f.Dubravë, lagjja Malëzez dhe lagjja Qorraj kanë të bëjnë me një pjesë krejt tjetër.

z.Ekrem Kyçyku, Dy dru që janë tharë, nuk janë ujit. Po të ishte ende thatësirë, do të ishin tharë edhe dru të tjerë. Mbi 50 pemë nuk kanë pasur sukses dhe keni thënë se do të zëvendësohen, mirëpo nuk janë zëvendësuar mbi urën e "Hazir Jahës". Para banesës madhe janë 18 pemë që nuk kanë pasur sukses, por nuk janë zëvendësuar.

Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli, a keni edhe dikush diçka lidhur me këtë pikë të rendit të punës? Nëse jo, ky raport është vetëm si njoftim që i vjen Kuvendit të Komunës për diskutim. Atëherë konstatoj se Kuvendi i Komunës u

Njoftua

Me Raportin Gjashtëmujor Financiar për Periudhën Janar- Qershor 2021/ Lënda 01Nr.05-400/01-25331/21.

3.Propozim Vendim për transfer të mjeteve sipas buxhetit të vitit 2021

Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli, Drejtori është këtu. Mjetet për transfer janë mjete të cilat teprojnë. Nëse keni diçka lidhur me këtë pikë urdhëroni.

z.Bahri Selimi, Transferi është bërë. Ndërtimin e QMF në f.doganaj e kemi pas prioritet me realizuar për dy vite. Në anën tjetër nga Qeveria e kemi marrë një vendim që nuk guxojmë të furnizohemi me ato mjete dhe te e njehta drejtori, vetëm e kemi bërë kërkesën për rialokim të mjeteve. Ato mjete që shkojnë suficit, pas aprovimit nga ju, ato mjete barten te QMF Doganaj dhe realizohen këtë vit.

Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli, Nëse nuk keni diçka tjetër për diskutim, a jeni që ky propozim vendim për transfer të mjeteve sipas buxhetit të vitit 2021 të aprovohet? Propozim vendimin për transfer të mjeteve sipas buxhetit të vitit 2021 e shtroj në votim dhe i njehti u aprovua me 15 vota Për, 9 vota kundër, abstenim nuk pati. Gjatë votimit të kësaj pike, 3

anëtarë të Kuvendit të Komunës nuk ishin të pranishëm(Selim Reka, Adnan Reka dhe Kadri Krivenjeva).Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për transfer të mjeteve sipas buxhetit të vitit 2021/Lënda 01Nr.400/01-24412/21

4.Propozim Vendim për aprovimin e listës së veçantë të pronave komunale të cilat do të jepen në shfrytëzim në vitin 2022

Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli, Me ligjin e ri për dhënie në shfrytëzim të pronave komunale kërkohet që paraprakisht komunat të kenë një list të aprovuar në Kuvendin e Komunës për pronat që do të jepen në shfrytëzim në vitin vijues. Komuna ka përpiluar këtë list të pronave të cilat mund të jepen në shfrytëzim në vitin e ardhshëm. Nëse keni diçka lidhur me këtë pikë, urdhëroni.

z.Ekrem Raka, Unë kamë vërejtje për këtë listë.E para i keni sjellë vetëm dy faqe dhe nuk është kompletu., nuk e di ku janë parcelat. E dyta, Komuna duhet të ketë kujdes se nëse ndonjëra nga parcelat i duhen komunës në të ardhmen për të ndërtuar ndonjë objekt për institucione komunale.Shtet ndërtimi parasheh krijimin e institucioneve të reja, ato pastaj kërkojnë objekte të reja.Unë do të votoj kundër.


Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli, mendoj që Komuna i ka shqyrtuar ato mundësi të cilat i duhen. Kjo është një listë paraprake që mund të ndryshoj, në bazë të kërkesa dhe nevojave që mund të paraqiten, mund të hiqen pa ndonjë problem.A ka edhe dikush tjetër për diskutim rreth kësaj pike.Nëse jo atëherë Propozim Vendim për aprovimin e listës së veçantë të pronave komunale të cilat do të jepen në shfrytëzim në vitin 2022 e shtroj në votim për aprovim.Në votim morën pjesë 25 anëtarë të Kuvendit të Komunës, ndërsa 2 anëtarë(Selim Reka dhe Adnan Reka) nuk ishin të pranishëm dhe votimi është si vijon: 11 vota Për , 12 vota Kundër dhe 2 abstenime.Në sajë të kësaj del se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për refuzimin e Propozim Vendimit për aprovimin e listës së veçantë të pronave komunale të cilat do të jepen në shfrytëzim në vitin 2022/Lënda 01Nr.60/01-25522/21.

Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, kështu që konstatohet mbledhjen të përfunduar në ora 12:00. Deri fund të mbledhjes qëndruan 25 anëtarë, pasi që anëtarët Selim Reka dhe Adnan Reka me lejen e Kryesuesit të Kuvendit dolën me herët nga mbledhja.

Procesmbajtës
Arbnora Kuka




REGJISTËR I ANTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS
(të zgjedhur në votimet e datës 22 Tetor 2017);

nga Mbledhja e IX-të (Nëntë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës për vitin 2021, mbajtur me 31 Gusht 2021

1. Kemal Mërseli.....,
2. Hamid Guri.....,
3. Ahmet Luma,
4. Kadri Krivenjeva,.....,
5. Besim Vishi,.....,
6. Sali Malsiu.....,
7. Lirije Dema.....,
8. Pranverë Loku- Zharku.....,
9. Lirije Luta.....,
10. Vlora Dalloshi.....,
11. Nexhat Loku,
12. Agim Mani.....,
13. Adnan Reka.....,
14. Ekrem Kyçyku.....,
15. Fatijona Kyçyku.....,
16. Kaltrina Kodra.....,
17. Selim Reka.....,
18. Besnik Salihu,.....,
19. Nazife Krasniqi.....,
20. Arlinda Rakoci-Raka.....,
21. Shemsedin Luzha.....,
22. Albana Lika.....,
23. Rabije Sallahi,.....,
24. Hajredin Luta.....,
25. Hafize Sallahi,
26. Bekim Koxha.....,
27. Ekrem Raka,......



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

- Kuvendi i Komunës -

REGJISTËR I ANTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS KAÇANIK
(zgjedhur në votimet e 22 Tetorit 2017)

Evidenca e pjesëmarrjes së anëtarëve të Kuvendit të Komunës, në mbledhjen e IX-të (Nëntë) të Rregullt për vitin 2021, mbajtur me 31 Gusht 2021

1	2	3	4	5
Nr. R	Emri dhe Mbiemri	pozita	Përkatësia Politike	Nënshkrimi
01.	Hamid Guri	anëtar	PDK	
02.	Ahmet Luma	"	PDK	
03.	Kadri Krivenjeva	"	PDK	
04.	Besim Vishi	"	Nga PDK/ në LVV	
05.	Sali Malsiu	"	PDK	
06.	Lirije Dema	"	PDK	
07.	Pranverë Loku-Zharku	"	PDK	
08.	Lirije Luta	"	PDK	
09.	Vlora Dallosi	"	PDK	
10.	Nexhat Loku	"	PDK	
11.	Agim Mani	"	LVV	
12.	Adnan Reka	"	LVV	
13.	Ekrem Kyçyku	"	LVV	
14.	Fatijona Kyçyku	"	LVV	
15.	Kaltrina Kodra	"	LVV	
16.	Selim Reka	"	LDK	
17.	Besnik Salihu	"	LDK	
18.	Nazife Krasniqi	"	LDK	
19.	Arlinda Rakoci-Raka	"	LDK	
20.	Shemsedin Luzha	"	Nga AAK/ në Grup të Pavarur (GP) nga GP/ i Pavarur/ i Pavarur nga i Pavarur në LVV- Nga AAK/ në Grup të Pavarur (GP) Nga GP në LVV	
21.	Albana Lika	"	AAK	
22.	Rabije Sallahi	"	Nga AAK/ në Grup të Pavarur	
23.	Hajredin Luta	"	Nga NISMA/ në AAK	
24.	Hafize Sallahi	"	NISMA	
25.	Bekim Koxha	"	IQ Lista për Kaçanikun	
26.	Ekrem Raka	"		

Vërtetoj: Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli

